

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E HENE 14 SHTATOR 2023

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Tashmë, që nga fillimi i luftës së Ruisë kundër Ukrainës, më 24 shkurt të vitit 2022, janë shënuar pothuajse 19 muaj. Luftë, e cila përkoi me një moment kyç për politikën e jashtme të Shqipërisë si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Pavarësisht se Shqipëria është një vend i vogël në tryezën më të rëndësishme të politikës së jashtme dhe të sigurisë botërore, vende me një dimension tjetër sa historik edhe politik, përfaqësimi ynë në këtë tryezë jo vetëm tregoi përmasat e mëdha në politikën e jashtme të një vendi të vogël, por edhe besueshmërinë e një aleati që mbështet 100% politikat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian në politikën e jashtme dhe konkretisht për masat ndaj Ruisë. E theksuar qartë edhe në progresraportin e vitit 2022 të BE-së për Shqipërinë, është vlerësuar pozitivisht qëndrimi i Shqipërisë në përputhje me të gjitha vendimmarrjet e 27 vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për luftën e paprovokuar të Ruisë. Shqipëria ishte bashkëhartuese me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Këshillin e Sigurimit, të rezolutës për masat ndaj Ruisë për shkak të kësaj lufte. Qeveria shqiptare, Kryeministri Rama, mbajtën menjëherë publikisht në arenën ndërkombëtare qëndrimet dhe shprehën vullnetin dhe angazhimin për të qenë përkrah aleatëve kundër Ruisë, në këtë luftë të paprecedentë në kohërat e sotshme. Shqipëria ka qenë ndër vendet e para që ka ratifikuar dhe ka mbështetur menjëherë të gjitha rezolutat, rekomandimet dhe vendimet e ndërmarra nga organizmat ndërkombëtare kundër Ruisë. Shqipëria ka mbështetur dhe ka votuar, gjithashtu, vendimin e menjëhershëm për përjashtimin e Ruisë nga Këshilli i Europës dhe pezullimin e saj nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Ashtu si edhe ne, si delegacion shqiptar në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, pavarësisht ndasive tona në politikën e brendshme, për këtë çështje në Strasburg, duhet thënë se kemi mbajtur të njëjtin qëndrim, si mazhorancë dhe opozitë. Në 16-17 maj të këtij viti, në Rejkjavik u mbajt samiti i katërt i Këshillit të Europës me liderët e 46 vendeve të Këshillit të Europës, ku Shqipëria shprehu vullnetin dhe angazhimin e saj konkret për këtë marrëveshje të propozuar në funksion të mbrojtjes së sovranitetit të Ukrainës, vlerave të demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe vendosjes përpara përgjegjësisë të përgjegjësve të kësaj lufte. Kjo marrëveshje parashikon krijimin e regjistrit të dëmeve të shkaktuara nga agresioni i Ruisë kundër Ukrainës, i cili do të shërbejë për të dokumentuar dëmet, humbjet ose dëmtimet e shkaktuara ndaj personave fizikë dhe juridikë në Ukrainë, përfshirë këtu edhe shtetin. Regjistri, i deklaruar edhe në këtë marrëveshje që po ratifikohet sot, nuk do të ketë asnjë funksion gjykimi në lidhje me këto pretendime, por është hapi i parë drejt një mekanizmi ndërkombëtar kompensimi për viktimat e këtij agresioni. Ky regjistër është një moment historik i rëndësishëm në rrugën drejt drejtësisë dhe dëmshpërblimeve për Ukrainën. Sot nga të gjitha vendet e Këshillit të Europës, më shumë sesa vullnet, kërkohet angazhim, si një politikë detyruese e unifikuar në mbështetje të Ukrainës. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për të garantuar çështjet e shtetit ligjor apo atë që konsiderohet drejtësia ndërkombëtare, por edhe për të mbrojtur sigurinë dhe stabilitetin e kontinentit dhe të gjithë botës. Ideja e krijimit të regjistrit për pasojat e luftës fillimisht është ngritur gjatë vitit 2022 në Kombet e Bashkuara dhe më pas në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, ku, nëpërmjet rezolutave të miratuara, është rekomanduar, pikërisht, ngritja e këtij mekanizmi, që u vu në jetë me vendimmarrjen e Samitit të Rejkjavik-ut.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, në rezolutën e qershorit të këtij viti, kërkoi edhe krijimin e një mekanizmi ndërkombëtar të kompensimit për të gjitha viktimat e kësaj lufte, për familjarët e tyre, për personat që kanë mundur të mbijetojnë, veçanërisht për gratë dhe vajzat, që kanë qenë viktime edhe të akteve seksuale, por edhe vetë shtetit të Ukrainës. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje në mënyrë unanime në Parlament tregon se kemi vullnetin dhe angazhimin konkret për të vijuar ndjekjen e të gjitha detyrimeve tona për të mbështetur Ukrainën dhe për të treguar të gjithë së bashku vendosmëri në masat kundër Ruisë. Nga ana tjetër, një votim unanim do të tregonte, gjithashtu, që jemi në kahun e duhur të historisë.

Faleminderit!

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E HENE 14 SHTATOR 2023

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Këto marrëveshje, si marrëveshja për njohjen e kontributeve shoqërore mes shteteve, siç ishte rasti i Malit të Zi për pjesën e kontributeve, apo kjo marrëveshje që po lidhim me Sllovakinë për të eliminuar tatimin e dyfishtë dhe për të parandaluar evazionin fiskal, janë marrëveshje shumë të rëndësishme, sepse prekin drejtpërdrejt qytetarët. Kur sheh që kolegët e nderuar deputetë nuk janë në sallë për të diskutuar për këto çështje, që janë shumë të rëndësishme për qytetarët, të vjen keq që seanca mbushet me retorikë boshe dhe me retorikë politike, duke mos diskutuar për ata që secili nga ne ka nderin të përfaqësojë, për qytetarët shqiptarë. Po e bëj këtë diskutim jo vetëm si relatore e kësaj marrëveshjeje në Komisionin për Politikën e Jashtme, ku është diskutuar gjerësisht. Ky është një ligj, që i shërben plotësisht të kushteve dhe rekomandimeve të lëna nga BE-ja në kuadër të procesit të integritimit evropian. Integrimi i Shqipërisë në BE shërben jo vetëm për të qenë pjesë e familjes së madhe europiane, por edhe për transformimin e vendit, në radhë të parë, për konsolidimin e shtetit të së drejtës, për zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë vendase, si dhe për integrimin e vendit tonë në ekonominë e vendeve anëtare të BE-së. Kjo marrëveshje përmban dy objektiva: Së pari, krijon një kuadër të plotë ligjor për të eliminuar tatimin e dyfishtë për të gjithë individët apo personat juridikë shqiptarë, që ushtrojnë aktivitete biznesi në të dy vendet respektive, duke reduktuar ngarkesën tatimore për këto biznese, që shpeshherë ka krijuar një barrë financiare të tepërt dhe ndikon në ndërprerjen e investimeve apo edhe të tregtisë. Marrëveshje të tilla janë mjet kyç për rritjen e sigurisë, inkurajimin e investimeve të huaja, krijimin e vendeve të punës dhe nxitjen e lëvizjes së lirë të kapitalit dhe burimeve njerëzore. Së dyti, krijon një bazë të mirë ligjore për të luftuar evazionin fiskal dhe krimin ekonomik, që mund të ndodhë për shkak të hapësirave që krijohen nga mungesa e një legjislacioni të plotë. Sot, në një dimension të ri të lëvizjes së njerëzve, kuptohet që lufta ndaj evazionit fiskal apo më gjerë, krimin ekonomik, mund të realizohet vetëm nëpërmjet bashkëpunimeve dypalëshe apo shumëpalëshe.

Vlen të theksohet që vendi ynë ka ratifikuar plot 43 marrëveshje të ngjashme dhe kjo është e 44-ta, e cila krijon mundësinë që të eliminohet kjo barrë fiskale, që ne u krijojmë qytetarëve shqiptarë nga mungesa e këtij legjislacioni. Pavarësisht kësaj, Shqipëria ka ndërmarrë edhe detyrime, që kanë rrjedhur nga konventa multilaterale për zbatimin e masave të traktatit tatimor për të parandaluar evazionin fiskal, si palë e kësaj konvente që nga viti 2019, kohë në të cilën Shqipëria e ka nënshkruar. Aderimi në këtë konventë i ka dhënë mundësi Shqipërisë që jo vetëm të ulë burokracinë, por edhe të reduktojë kohën që i nevojitet për rishikimin dhe amendimin e secilës marrëveshje dypalëshe, që mund të jetë hartuar përpara se Shqipëria të bëjë palë në këtë marrëveshje. Kjo paketë i pajis shtetet pjesëmarrëse me instrumente vendase dhe ndërkombëtare për të adresuar shmangien e taksave, në mënyrë që fitimet të taten aty ku kryhen aktivitetet ekonomike, që i gjenerojnë ato, dhe aty ku krijohet vlera. Vendet nënshkruese, duke e ditur se evazoni fiskal mund të trajtohet në mënyrë efektive, vetëm në nivel global, janë angazhuar, nëpërmjet marrëveshjes për miratimin e një standardi të ri të vetëm global, për shkëmbimin automatik të informacionit të tatimpaguesve dhe zbatimin e njëjtë dhe efektiv të këtij standardi. Pavarësisht kuadrit ndërkombëtar për eliminimin e tatimit të dyfishtë dhe krimit ekonomik, veçanërisht evazionit fiskal, marrëveshje të tilla bilaterale shërbejnë për t'u dhënë garancitë e nevojshme subjekteve tregtare, por edhe angazhimin dypalësh në luftën kundër evazionit fiskal. Marrëveshja vjen në një linjë me rekomandimet e dhëna nga progresraportet e BE-së, e përmendur kjo edhe në progresraportin e vitit 2022. Sot që Shqipëria ka përfunduar procesin screening për grupkapitujt që lidhen me ekonominë, një pjesë e rekomandimeve të BE-së veçon lidhjen dhe ratifikimin e këtyre marrëveshjeve dypalëshe në fushën ekonomike. Në përpjekje për të shmangur krimin ekonomik do të duhet shumë punë për të luftuar me evazionin fiskal në nivel transnacional, por edhe në mënyrë bilaterale mes vendeve tona. Një ndër rekomandimet e BE-së në fushën e bashkëpunimit administrativ dhe ndihmës së ndërsjellë është edhe nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale me Sllovakinë, Danimarkën, Qipron, Finlandën, Portugalinë dhe Lituaninë, si dhe është për t'u përgëzuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë për diskutimin në komision, si dhe për angazhimin në fillimin e negociatave për të lidhur marrëveshje me këto vende të rekomanduara nga BE-ja. Marrëveshje të tilla, si ajo që u diskutua pak më herët, për njohjen e sigurimeve shoqërore mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, janë një përfitim i drejtpërdrejtë për qytetarët, në këtë dimension më të gjerë të lëvizjes dhe punësimit të shtetasve shqiptarë. Tashmë që procesi i screening është në përfundim për të gjithë grupkapitujt, do të duhet një angazhim më i madh në përgatitjen e harmonizimit të legjislacionit me dispozitat e BE-së në fushën e ekonomisë, veçanërisht në forcimin e përpjekjeve të përbashkëta për të luftuar evazionin fiskal.

Faleminderit!